



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr 41 / Prot  
8

Vlorë, më 31 . 12 . 2020.

**VENDIM**

**Nr. 02 , datë 28.12.2020**

**PËR**

**RINOVIMIN E LEJES PËR PRODHIM HIDROENERGJIE**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të VKM-së nr.550, datë 15.07.2020 “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Vjosë, Këshilli i Basenit Ujor Vjosë,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e rinovimit të lejes për prodhim hidroenergjie, për Hec Rajan, subjektit “Balkan Green Energy” Sh.p.k;
2. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Vjosë, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**

**FLAMUR MAMAJ**



